

**KONTRATË SHITBLERJE TË KUOTAVE TË KAPITALIT
THEMELTAR TË SHOQËRISË "BEST AIR TECH" SH.P.K**

Sot më date 23.01.2020 në selinë e shoqërisë 'Best Air Tech' SHPK me Nipt L82411021U me adresë :Rruga Mihal Grameno (Petro Nini Luarasi), zk 8160, Nr pasurie 3/932 Tiranë redaktohet kjo kontrate per shitjen e kuotave midis palëve:

SHITËSIT:

Z.Artjon Shytaj lindur më 18.03.1983 dhe banues në Tiranë me Nr. Personal I30318065I me zotësi të plotë për të vepruar ,zotërues i 25% të kapitalit themeltar të Shoqërisë;

Z.Ardit Shehu lindur më 23.04.1982 dhe banues në Tiranë me Nr. Personal I20423081R me zotësi të plotë për të vepruar , zotërues i 25% të kapitalit themeltar të Shoqërisë;

Z.Bledi Beba lindur më 22.04.1981 dhe banues në Tiranë me Nr.Personal I10422146G me zotësi të plotë për të vepruar, zotërues i 25% të kapitalit themeltar të Shoqërisë;

Z.Oltjon Shkurti lindur më 07.09.1980 dhe banues në Tiranë me Nr. personal I00907045A me zotësi të plotë për të vepruar , zotërues i 25% të kapitalit themeltar të Shoqërisë ;

BLERËSI:

Z.Genci Gërmau lindur më 20.08.1983 dhe banues në Tiranë me Nr.Personal I30820071I me zotësi të plotë për të vepruar;

Sa më sipër referuar dispozitave ligjore të Kodit Civil të Republikë së Shqipërisë konkretisht Neneve: 79,80,659,690 dispozitave të Ligjit Nr. 9901/2008 " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe Vendimit Nr.____ Prot. datë __.01.2020 të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërië "Best Air Tech" SH.P.K palët e sipërcituara disponojnë lirisht me vullnet të plotë si mëposhtë vijon:


NENI 1

OBJEKTI I KONTRATËS:

Objekti i kësaj kontrate është transferimi nëpërmjet kontratës së shitjes i pjesëve prej 20% të kapitalit themeltar të shoqërisë nga ortakët aktual ,Z.Artjon Shytaj , Z.Oltjon Shkurti , Z. Bledi Beba dhe Z. Ardit Shehu tek pala blerëse Z.Genci Gërmau.

Z.Artjon Shytaj në cilësinë e ortakut të shoqërisë "Best Air Tech" SH.P.K zotërues I 25% të kapitalit themeltar i shet Z.Genci Gërmau 1/5 e % që zotëron të kapitalit themeltar të shoqërisë, kundrejt cmimit 625.000 (gjashtëqindë e njëzetë e pesë mijë) lekë , e barazvlefshme me 5% të kapitalit themeltar të Shoqërisë;

Z.OltjonShkurti në cilësinë e ortakut të shoqërisë "Best Air Tech" SH.P.K zotërues I 25% të kapitalit themeltar i shet Z.Genci Gërmau 1/5 e që zotëron të kapitalit themeltar të shoqërisë, kundrejt cmimit 625.000 (gjashtëqindë e njëzetë e pesë mijë) lekë , e barazvlefshme me 5% të kapitalit themeltar të Shoqërisë;



Z. Bledi Beba në cilësinë e ortakut të "Best Air Tech" SH.P.K zotërues I 25% të kapitalit themeltar i shet Z.Genci Gërmau 1/5 e që zotëron të kapitalit themeltar të shoqërisë, kundrejt cmimit 625.000 (gjashtëqindë e njëzetë e pesë mijë) lekë , e barazvlefshme me 5% të kapitalit themeltar të Shoqërisë;

Z.Ardit Shehu në cilësinë e ortakut të shoqërisë "Best Air Tech" SH.P.K zotërues I 25% të kapitalit themeltar i shet Z.Genci Gërmau 1/5 e që zotëron të kapitalit themeltar të shoqërisë, kundrejt cmimit 625.000 (gjashtëqindë e njëzetë e pesë mijë) lekë , e barazvlefshme me 5% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.;

Për realizimin e transferimit të pjesëve ngakuotat e zotëruara respektivisht nga ortakët, si dhe për pranimin në ortakërinë e shoqërisë së ortakëve të rinj ,është dhënë miratimi nga të 4 (katërt) ortakët aktual sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve Nr.2 Prot. Datë 23.01.2020

NENI 2

CMIMI I SHITJES SË KAPITALIT DHE MËNYRA E PAGESËS:

Paketa e kapitalit themeltar në masën 20% është vlerësuar nga palët në vlerën 2.500.000 (dy milion e pesëqind mijë) lekë.

Pagesa në shumën e mësipërme do të kryhet deri në datën 28.02.2020.

NENI 3

MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISE SË KAPITALIT

Me nënshkrimin e kësaj kontrate ,pala shitëse Z.Artjon Shytaj humbet 1 (një) koutë që përfaqëson 5% të kapitalit themeltar të shoqërisë "Best Air Tech" SH.P.K , pronësinë e të cilit e fiton nëpërmjet kësaj kontrate Z. GenciGërmau;

Me nënshkrimin e kësaj kontrate ,pala shitëse Z.Oltjon Shkurti humbet 1 (një) koutë që përfaqëson 5% të kapitalit themeltar të shoqërisë "Best Air Tech" SH.P.K , pronësinë e të cilit e fiton nëpërmjet kësaj kontrate Z. GenciGërmau;

Me nënshkrimin e kësaj kontrate ,pala shitëse Z.Ardit Shehu humbet 1 (një) koutë që përfaqëson 5% të kapitalit themeltar të shoqërisë "Best Air Tech" SH.P.K , pronësinë e të cilit e fiton nëpërmjet kësaj kontrate Z. GenciGërmau;

Me nënshkrimin e kësaj kontrate ,pala shitëse Z.Bledi Beba humbet 1 (një) koutë që përfaqëson 5% të kapitalit themeltar të shoqërisë "Best Air Tech" SH.P.K , pronësinë e të cilit e fiton nëpërmjet kësaj kontrate Z. GenciGërmau.;

Transferimi I kuotave nga palët shitëse tek pala blerëse bëhet në vlerën e tyre respektive nominale dhe pala blerëse përmes fitimit të pronësisë së koutave respektive fiton cdo të drejtë ligjore si dhe men për sipër cdo detyrim në vlerën e kuotës që ai përfiton në shoqërinë "Best Air Tech" SH.P.K

NENI 4

PËRGJEGJËSITË DHE GARANCITË

Shitësit nëpërmjet kësaj kontrate për shitje kuotash garantojnë si më poshtë:

- Se janë të vetmit titullar të lëshshëm të kuotave që po transferohen me këtë kontratë shitjeje ;
- Se kuotat objekt shitje janë plotësisht janë të lira nga cdo barrë ,detyrim , të drejta reale apo cdo lloj kufizimi tjetër;
- Se shoqëria nuk ka detyrime financiare të pashlyera apo aq më tepër të padeklaruar ndaj të tretëve , përvec atyre të deklaruara në pasqyrat financiare të shoqërisë që i janë bërë të ditura palës blerëse përpara nënshkrimit të kësaj kontrate ;

Blerësi nëpërmjet nënshkrimit të kësaj kontrate garanton se :

- Të ardhurat e tij janë përfituar në mënyrë të ligjshme,nga kursimet familjare dhe jane të lira nga cdo lloj barre , detyrimi apo të drejta reale apo cdo lloj kufizimi tjetër;

NENI 5

PËRBËRJA E SHOQËRISË

Pas nënshkrimit të kësaj kontrate dhe regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit, shoqëria "Best Air Tech" SH.P.K do të ketë në përbërje të saj këtë ortakëri:

1-Z.ArtjonShytaj ,zotëron 1(një) kuotë qe përfaqeson 20% të kapitalit themeltar të shoqërisë .

2-Z.OltjonShkurti , zotëron 1(një) kuotë qe përfaqeson 20% të kapitalit themeltar të shoqërisë .

3-Z.Ardit Shehu, zotëron 1(një) kuotë qe përfaqeson 20% të kapitalit themeltar të shoqërisë .

4-Z.Bledi Beba, zotëron 1(një) kuotë qe përfaqeson 20% të kapitalit themeltar të shoqërisë .

5-Z.Genci Gërmau, zotëron 1(një) kuotë qe përfaqeson 20% të kapitalit themeltar të shoqërisë .

Në të njëjtat raporte me përqindjet e kuotave që zotërojnë në shoqëri ortakët marrin përsipër edhe detyrimet sikundër gëzojnë edhe të drejtat sipas Ligjit Nr. 9901/2008 " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"

NENI 6

TË NDRYSHME

Ngarkohet Administratori Z. Artjon Shytaj ose persona të autorizuar prej tij që të kryejë regjistrimin e kësaj kontrate në QKB me efekt të ligjshëm nga data e kontratës;

Palët deklarojnë që janë dakort me përmbajtjen e bërë në këtë kontratë dhe se ortakëria e shoqërisë tregtare në vijim do të jetë sipas nenit 5 të kësaj kontrate;

Kontrata redaktohet në 6 ekzemplarë autentik në gjuhën shqipe me të njëjtën vlerë juridike. Secila palë mban nga një ekzemplarë , ndërsa një ekzemplarë depozitohet në QKB sipas ligjit;

Palët deklarojnë se nuk kanë asnjë pretendim për sa më sipër dhe se kanë disponuar me vullnet të lirë ,të plotë dhe të pavesuar;

Pavlevshmëria e pjesëve të vecanta të kësaj kontrate nuk e cënojnë në thelb qëllimin e saj për transferim të kuotave respektive sipas nenit 3 të kësaj kontrate nga shitësit tek pala blerëse;

Cdo mosmarrëveshje midis palëve do të zgjidhet me mirëkuptim ,në të kundërt kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë;


Kontratës i bashkangjiten kopje të letërnjoftimeve të palëve shitëse dhe blerëse dhe kopje e ekstraktit të Shoqërisë;

Përfundimisht palët kontraktore , pasi redaktuan bashkarisht këtë kontratë sipas vullnetit të lirë dhe të plotë e lexojnë bashkarisht kontratën dhe pasi e gjejnë në përputhje me qëllimin e tyre si dhe vullnetin e lirë kontraktor , e nënshkruajnë personalisht duke I dhënë fuqi ligjore;

PALËT KONTRAKTORE

PALA SHITËSE

Z.Artjon Shytaj


Z. Ardit Shehu


Z.Oltjon Shkurti

Z. Bledi Beba


Z. Bledi Beba

PALA BLERËSE

Z.Genci Germau


Z. Genci Germau